


Letër familjes

I dashur nxënës, të dashur anëtarë të familjes,

Gjatë javëve të ardhshme do të njihemi me shumë situata që kanë të bëjnë me probabilitetin. Për të gjetur se ç'probabilitet ka që të ndodhë diçka, në fillim duhen gjetur të gjitha rezultatet e mundshme. Për shembull, në rast se nxirrni kube nga një çantë që përmban 3 kube të kaltra, 2 të gjelbra dhe 5 të bardha, ka 10 rezultate të mundshme: të dhjetë kubet. Probabiliteti që të nxirrni një kub të gjelbër është herësi i pjesëtimit të numrit të kubeve të gjelbra, 2, me numrin e përgjithshëm të rezultateve: $\frac{2}{10}$.

Së shpejti do të shqyrtojmë në klasë situata më të ndërlikuara. Për shembull, përfytyroni një situatë të tillë kur nxirrni një kub nga çanta, e mbani jashtë dhe pastaj nxirrni një kub tjetër. Do të mësojmë si të përlllogaritim probabilitete të tilla si probabiliteti për të nxjerrë në fillim një kub të gjelbër pastaj një kub të kaltër, duke përdorur metoda nga një degë e matematikës që quhet *kombinatorikë* – e cila na lejon të gjejmë kombinimet e mundshme të objekteve. Një metodë e tillë do të ishte të vizatonim një diagram pemë, si ky në vijim; të mbanim shënim të gjitha 10 rastet e mundshme të tërheqjes së parë, dhe pastaj për çdo tërheqje të shënonim 9 rezultatet e mundshme të tërheqjes së dytë. Në vazhdim tregohen degëzimet e një diagrami pemë kur me tërheqjen e parë kemi nxjerrë një kub të gjelbër:

Tërheqja e parë



Tërheqja e dytë
e mundshme

Në fund të këtij kapitulli, do të zbatojmë çfarë kemi mësuar për të analizuar paanshmërinë dhe probabilitetet në lojra të ndërlikuara, si në finalet sportive dhe në llotaritë shtetërore. Do t'u japim përgjigje pyetjeve të tilla si:

- Cilat janë shanset për të fituar në ndonjë llotari?
- A favorizohet ndonjë skuadër nga një strukturë e caktuar e finaleve?
- Cila strukturë e finaleve është më e paanshmja, në një situatë të dhënë?

Fjalor Në këtë kapitull do të ndeshemi me vetëm një term të ri fjalori – *hapësirë e kampionit*. Hapësira e kampionit do të na ndihmojë për të përlllogaritur probabilitetin e ngjarjeve të ndryshme.

Çfarë mund të bëni në shtëpi?

Gjatë javëve të ardhshme nxënësi mund të tregojë interesim në lëmin e probabilitetit. Mund ta ndihmoni të mendojë për raste të zakonshme ku ndeshemi me probabilitete, të tilla si llotaritë; ose mund të luani me të një lojë e cila përdor zaret, rrotën e fatit dhe në përgjithësi probabilitetet.

